

Ndryshimet tatimore në 2006

Tashmë është bërë traditë në Shqipëri, që, krahas miratimit të projekt-buxhetit, të bëhen edhe ndryshime në Ligjet dhe Udhëzimet Tatimore. Çdo vit, nevojat me të cilat argumentohen ndryshimet dhe synimet e paketës fiskale janë shumë të ngjashme, aq sa të krijohet përshtypja që vitin e ardhshëm tatimet nuk do të ndryshojnë më, por, përsëri ndodh një skenar i ngjashëm, që me sa duket është i natyrshëm po të kihet parasysh tradita relativisht e pakët në hartimin dhe zbatimin e sistemeve tatimore, si edhe kompleksiteti i zhvillimeve biznesore dhe globalizimi i shpejtë.

Në fakt nëpërmjet ndryshimeve në paketën fiskale është synuar që të reflektohen problemet e akumuluar gjatë vitit, të cilat kanë patur si nevojë të domosdoshme ndryshimin e ligjit apo sqarimin e procedurave nëpërmjet udhëzimit, por, në të njëjtën kohë, është synuar “të kënaqen” nisma politike apo biznesore me qëllim që të përmirësohen mardhënjet e partneritetit midis shtetit dhe tatimpaguesve, të përafrohet legjislacioni Shqiptar me atë të rajonit apo të BE, të luftohet evazioni fiskal dhe kontrabanda, të përmirësohet shërbimi ndaj tatimpaguesve, të zbatohen rekomandimet e FMN-së, të krijohet një mjedis atraktiv biznesor dhe të thjeshtohen procedurat administrative, etj., duke kompletuar kështu skenarin e përvitshëm të përmirësimeve në paketën fiskale.

Por, cilat janë ndryshimet konkrete në vitin 2006 dhe sa i kanë shërbyer ato synimeve të sipër-përmendura? Në vijim është një trajtim dhe analizë përmbledhëse e tyre:

1. Tatimi mbi vlerën e shtuar. Siç edhe është diskutuar shumë në median e shkruar dhe atë elektronike, në paketën fiskale 2005 u parashikua që në Janar 2006 të fillonte aplikimi i tvsh-së në shitjen e parë të ndërtesave. Me paketën 2006, kjo dispozitë u shfuqizua, pra shitja e ndërtesave mbetet furnizim i përjashtuar. Pamvarësisht nga argumentat që favorizonin aplikimin e tvsh-së në shitjen e ndërtesave, mendoj se nuk ishte bërë përgatitja e nevojshme si nga ana e administratës tatimore ashtu edhe nga ana e biznesit, dhe nuk ishte arritur një konsensus midis tyre, gjë që do ta bënte të vështirë administrimin e tatimit. Në këto kushte mos aplikimi i tvsh-së mendojmë se është i drejtë. Një tjetër përmirësim, nëse mund të quhet i tillë, pasi rrit fuqitë diskrete apo arbitrare të qeverisë dhe dobëson mardhëniet e partneritetit me biznesin, është ai që ka të bëjë me procedurat e përcaktimit të çmimeve orientuese minimale fiskale për procesin e ndërtimit të banesave, gjë që do të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave pas këshillimit me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë. Kjo i jep fund marrëveshjeve midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë, që, pa dyshim, i shërbyen pozitivisht administrimit të tatimeve për kohën që u përdorën. Tani, me sa duket, qeveria ka vendosur të jetë disi më arbitrare në vendosjen e këtyre çmimeve, me synim rritjen e të ardhurave, por, nga ana tjetër, një gjë e tillë do të dobësojë apo acarojë mardhëniet e qeverisë me industrinë e ndërtimit, që, pa dyshim, është dega kryesore e industrisë në vend dhe burim i rëndësishëm i punësimit dhe të ardhurave tatimore.

Një tjetër ndryshim në ligjin për TVSH-në ka të bëjë me zgjerimin e gamës së përjashtimeve për furnizimin e shërbimeve të shtypshkrimeve, furnizimin e gazetave, revistave dhe librave të çdo lloji, si dhe furnizimin e shërbimit të reklamave nga media e shkruar dhe ajo elektronike. Megjithë zgjerimin e përjashtimeve (gjë që

përgjithsisht nuk rekomandohet në TVSH) dhe trajtimin e favorizuar që i bëhet medias së shkruar dhe elektronike, mund të thuhet se ndryshimi i bërë unifikon dhe lehtëson administrimin e përjashtimeve në këtë fushë.

Përjashtimi nga TVSH-ja i lojrave të fatit, kazinove dhe hipodromeve, që ndoshta pa të drejtë u trumbetua shumë dhe mori ngjyra politike, nuk ishte veçse një rregullim korrespondues në Ligjin e TVSH-së, i domosdoshëm për t'u bërë për shkak të ndryshimeve që iu bënë Ligjit "Për Lojërat e Fatit, Kazinotë dhe Hipodromet" në Maj 2005. Heqja e tvsh-së për këto aktivitete ishte bërë që në Maj 2005, dhe u vendos aplikimi, në shumicën e rasteve, i kuotave fikse të tatimit për ato aktivitete.

2. Tatimi mbi të ardhurat personale. Ndryshe nga vendet e tjera, tatimi mbi të ardhurat personale në Shqipëri është pak i rëndësishëm përse i takon të ardhurave që realizohen prej tij. Ky tatim zë vetëm 1% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Sidoqoftë, për të diskutohet shumë pasi ai ndikon direkt në të ardhurat personale, sidomos në të ardhurat nga punësimi. Edhe këtë vit, si gjithmonë, ndryshimet në tarifatat progresive të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi janë prezente. Në paketën 2006 u hoqën tarifatat e larta prej 25% dhe 30%, duke mbetur si tarifë maksimale ajo prej 20% dhe u vendos një tarifë e re prej 1% për të ardhurat minimale. Tabela e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi është:

E ardhura e tatueshme (në muaj)	TAP		Përqindje
	Deri në (lekë)	Lekë	
0	14 000	0	+1 % të shumës mbi 0 lekë
14 000	40 000	140	+ 5% të shumës mbi 14 000 lekë
40 000	90 000	1 440	+ 10% të shumës mbi 40 000 lekë
90 000	200 000	6 440	+ 15% të shumës mbi 90 000 lekë
200 000	Më tepër	22 940	+ 20% të shumës mbi 200 000 lekë

Një ndryshim tjetër lidhur me tatimin mbi të ardhurat personale është heqja e detyrimit të individëve për paraqitjen e deklaratës integrale të tatimit mbi të ardhurat personale nga çfardo lloj burimi, detyrim ky i paraqitur një vit më parë në paketën fiskale 2005, por që, me sa duket, FMN dhe Ministria e Financave e kanë konsideruar të parakohëshëm, megjithë efektet pozitive që një masë e tillë do të kishte në edukimin e tatimpaguesve dhe në luftimin e evazionit fiskal.

Heqja e tatimit prej 20% mbi të ardhurat personale nga lojrat e fatit është gjithashtu një rregullim korrespondues që lidhet me ndryshimet e Majit 2005 në Ligjin për Lojrat e Fatit, Kazinotë dhe Hipodromet, ndryshime që sollën përmirësime të konsiderueshme në administrimin e tatimeve nga aktivitete të tilla.

Mendojmë se të gjitha përmirësimet e mësipërme në tatimin e të ardhurave personale ndikojnë pozitivisht në rritjen e formalitetit dhe luftimin e evazionit, megjithëse "pjesën e luanit" në ngarkesën fiskale të biznesëve lidhur me të punësuarit e kanë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore, të cilat në terma formale (tarifat sipas ligjit) janë në nivele normale apo të larta krahasuar me vendet e rajonit e më gjerë, ndërsa në terma reale, ajo gjë paguhet faktikisht, sidomos nga sektori privat

është në nivele shumë të ulta. Raportet faktike të kontributeve që paguhen nga sektori privat krahasuar me atë shtetëror janë shumë të ulta për sektorin privat, çka tregon nivelin të evazionit në këtë fushë (mosraportim i numurit të të punësuarve dhe nivelit real të pagave). Ulja e tarifave për kontributet e sigurimeve shoqërore, e shoqëruar me përmirësime në procedurat e administrimit dhe kontrollit, do të ndikonte ndjeshëm në uljen e evazionit tatimor.

3. Tatimi mbi fitimin. Përgjithsisht, në vendet e rajonit e më gjerë, vërehet një tendencë në uljen e tarifës së tatimit mbi fitimin, gjë e cila ka ndodhur edhe në vendin tonë. Tarifa e tatimit mbi fitimin ulet nga 23% në 20%, duke u bërë më konkurruese në rajon, me përjashtim të Serbisë dhe Maqedonisë ku tarifa e tatimit mbi fitimin është respektivisht 10% dhe 15%.

Një ndryshim që synon luftimin e shmangieve dhe evazionit dhe përmirësimin e administrimit të tatimit është futja e detyrimit për të gjitha organizatat jo fitimprurëse, institucionet, shoqatat, etj., për paraqitjen në organet tatimore të bilancit kontabël dhe pasqyrave të tjera financiare, edhe pse mund të jenë të përjashtuara nga tatimi mbi fitimin.

Një ndryshim tjetër pozitiv në Ligjin për tatimin mbi fitimin është rritja e normës së amortizimit për efekte fiskale për aktivet e patrupëzuara (programe kompiuterike, patenta, marka tregtare, etj.), nga 10% në 15%, duke stimuluar në këtë mënyrë rinovimin e këtyre aseteve.

Një përmirësim tjetër lidhet me procedurat e vendosura vitin e kaluar lidhur me dividendët dhe detyrimin e shoqërive për të vendosur dhe deklaruar destinimin e fitimit. Mosdeklarimi në tatime deri më 31 Korrik, për çfardolloj arsye, bënte që fitimi të konsiderohej dividend i shpërndarë dhe të tatohej me 10%. Në paketën 2006, një anomali e tillë u rregullua duke vendosur një gjobë fikse prej 25.000 lekë për çdo muaj vonesë.

4. Procedurat tatimore. Ndryshimet në Ligjin për Procedurat Tatimore kanë synuar thjeshtimin e procedurave, uljen e barrës administrative për tatimpaguesin dhe administratën tatimore, mbylljen e boshllëqeve dhe luftimin e evazionit, etj. Sidoqoftë, problem mbetet zbatimi korrekt i procedurave dhe i legjislacionit tatimor në përgjithsi, gjë që, me sa duket, kërkon kohë dhe ndryshime më radikale në sistemin tatimor, në administrimin e tatimeve, dhe veçanërisht në një nga funksionet kryesore të administratës tatimore që është shërbimi ndaj tatimpaguesve, që të bëhet sa më i lehtë, për të gjithë njëlloj, respektimi i detyrimeve dhe procedurave tatimore.

Fuqizimi i kompanive Shqiptare, zgjerimi i bizneseve dhe shtrirja territoriale duke krijuar degë e filjale, ka raste që është shoqëruar edhe me “lëvizje” apo “pozicionime” të qendrës së biznesit sipas interesave “miqësore”, pra duke mbajtur apo zhvendosur biznesin në atë degë tatimesh ku trajtimi ishte më “pozitiv” për tatimpaguesin. Një “manovrimi” të tillë i kundërvihet ndryshimi në Ligjin e procedurave që detyron regjistrimin e shoqërive në degën e tatimeve ku ndodhet vendi efektiv i menaxhimit të biznesit. Kritere më të detajuara për këtë qëllim parashikohet të jepen në Udhëzimin e Ministrisë të Financave.

Një tjetër përmirësim, në Ligjin e procedurave tatimore lidhet me metodat alternative të përcaktimit të detyrimit tatimor (aq shumë të përfolura dhe ndonjëherë me elementë abuzivë) në përcaktimin e detyrimeve tatimore nga administrata tatimore. Përmirësimi fut konceptin e vlerave orientuese tatimore (diçka e ngjashme me çmimet e referencës në dogana), të cilat do të përcaktohen me akte nën-ligjore, pas konsultimeve me shoqatat e specializuara të biznesit. Megjithë elementët e partneritetit në “konsultimet me shoqatat e biznesit”, fakti që çmimet orientuese do të përcaktohen me akte nënligjore, bart riskun e vendim-marrjes arbitrare nga ana e organeve shtetërore që do të nxjerrin aktin nën ligjor (Ministria e Financave apo Qeveria).

Një ndryshim tjetër ka të bëjë me procedurat e apelimit, duke saktësuar afatet në marrjen e njoftim-vlerësimeve apo njoftimeve të tjera nga organi tatimor. Kështu, për qëllime të ligjeve tatimore, data e marrjes së njoftim-vlerësimit apo çdo dokumenti tjetër zyrtar nga organet tatimore do të konsiderohet dita e dhtjetë pas ditës në të cilën njoftimi është dorëzuar në postë. Për çdo vonesë përgjegjësia bie mbi tatimpaguesin, pasi ai është i detyruar të deklarojë adresën e saktë dhe të sigurohet për marrjen në kohë të njoftimeve. Organet tatimore gjithashtu kanë të drejtë të dërgojnë dorazi njoftimet dhe datë e marrjes do të konsiderohet data e dorëzimit, pamvarësisht nëse tatimpaguesi pranon apo refuzon ta marrë njoftimin.

Një shtesë në nenin lidhur me procedurat e shqyrtimit të apelimeve tatimore sanksionon të drejtën e organeve që shqyrtojnë apelimet tatimore për heqjen pjesore ose tërësore të gjobave tatimore. Një tjetër ndryshim i lidhur me apelimet është krijimi i një drejtorie të specializuar për apelimet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me autoritetin e shqyrtimit të apelimeve tatimore dhe pamvarësinë në vendim-marrje. Kjo mendohet se do të rrisë efikasitetin e shqyrtimit të apelimeve tatimore.

Një tjetër shtesë sanksionon faktin se ligji për procedurat tatimore do të zbatohet njëjloj edhe për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.

Ndryshimet e mësipërme e të tjera më pak të rëndësishme të bëra në legjislacionin tatimor, sigurisht që kanë efektin e vet në ngarkesën tatimore dhe shpërndarjen e saj, në procedurat e mbledhjes dhe kontrollit të tatimeve, në nivelin e shërbimit ndaj tatimpaguesve, etj. Por, natyrshëm shtrohet pyetja: a arrihen synimet aq domethënëse për të cilat u hartua dhe miratua paketa fiskale? A ka realisht një pranim të gjerë të sistemit tatimor dhe të procedurave tatimore nga tatimpaguesit? A rritet niveli i plotësisimit vullnetar të detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit? A zgjerohet baza tatimore? dhe, ajo që është më e rëndësishme, A garantohet një trajtim i barabarë i tatimpaguesve? Sigurisht, nuk mund të ketë përgjigje të qarta e të sakta ndaj këtyre pyetjeve; ato vazhdimisht barten nga periudha në periudhë si objektiva e synime që, me sa duket, progresojnë ngadalë dhe do të mbeten të tilla edhe për shumë kohë. Sidoqoftë, një trajtim i barabartë me lehtësi proceduriale, pa barriera administrative e burokratike, qoftë edhe pa ulje të barrës fiskale, do të ishte i mirëpritur, jam i bindur, nga shumica dërmuese e tatimpaguesve të çdo lloji. Një pjesë e vogël e tatimpaguesve delinkuent që do të keqpërdornin shërbimin tatimor dhe ligjin, sigurisht do të përzgjidheshin lehtësisht nga analiza e riskut dhe do të kontrolloheshin dhe bëheshin objekt i masave shtërguese, por ato do të ishin veçse një pakicë.

Në këtë kontekst, do të dëshiroja të ndalesha në një “përmirësim” të vazhdueshëm të legjislacionit tatimor vitet e fundit që ndoshta nuk i ka shërbyer shumë barazisë

tatimore. Kjo është ulja e vazhdueshme e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin (apo e tatimit mbi xhiron e biznesit të vogël siç përdoret shpesh). Ky mund të konsiderohet avantazh vetëm për një grup tatimpaguesish, por jo përmirësim i sistemit tatimor. Ulja e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin ka thelluar vazhdimisht hendekun midis tatimpaguesve të biznesit të vogël dhe tatimpaguesve të TVSH-së. Kalimi si tatimpagues tvsh-je i një tatimpaguesi të biznesit të vogël, do të kishte një kosto shumë të lartë për tatimpaguesin. Në një rast të tillë, vetëm shpenzimet administrative do të kalonin ngarkesën tatimore si tatimpagues i biznesit të vogël e jo më detyrimet për tvsh-në dhe tatimfitimin që normalisht kalojnë shumë herë ngarkesën tatimore si tatimpagues i biznesit të vogël. Një hendek i tillë i madh bën tepër të vështirë kalimin normal të natyrshëm nga tatimpagues të biznesit të vogël në tatimpagues të TVSH-së. Tatimpaguesit e biznesit të vogël do të përpiqen me çdo kusht të gjejnë forma e mënyra për të mos kaluar në biznes të madh, deri edhe në “ndarjen” apo “mbylljen” e biznesit vetëm për arsye tatimore. Por, është një nga parimet themelore të sistemeve tatimore që, ato në asnjë rast nuk duhet të stimulojnë e aq më keq të detyrojnë marrjen e vendimeve të tilla. Në këto kushte, thellimi i hendekut biznes i vogël-tvsh ka ndikuar negativisht në arritjen e synive të mësipërme. Kalimi i tatimpaguesve të biznesit të vogël nën administrimin e pushteteve lokale do ta thellonte më tej këtë hendek. Në një rast të tillë transferimi i bizneseve nga “i vogli” tek “i madhi”, do të ishte vërtet “një betejë e vështirë” jo vetëm midis administratës tatimore me tatimpaguesit por ndoshta edhe midis pushtetit vendor dhe atij qendror. Ligji duhet të jetë i tillë që të gjithë tatimpaguesit të mëdhenj e të vegjël të kontribuojnë, në raporte të caktuara të drejta, si për për pushtetin qendror ashtu edhe për atë vendor.

Kjo ishte një përmbledhje dhe analizë e shkurtër e përmirësimeve të bëra në legjislacionin tatimor, që, sigurisht, përmban konsiderata personale dhe jo rezultate të studimeve apo analiza të thelluara e rekomandime që mund të rrjedhin prej tyre.

Fatmir Kazazi

Boga & Associates

Tiranë, 25 Janar 2006